

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Menaxhimi i Performances  
(zgjidhjet)

P8

Nr.

FLETË PROVIMI

**Udhëzime/:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT

.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data 26.10.2019

## Problemi 1

ABC ka zhvilluar një lloj të ri të karrigës së veturës. Koha e përlllogaritur e punës për njësinë e parë është 12 orë, por një kurbë e të mësuarit të fuqisë punëtore pritet të ndodhë në lartësi prej 75% për 8 njësitë e para të prodhuara. Kosto e punës është 15EURO/orë. Kosto e materialeve dhe shpenzimeve tjera të përgjithshme variabile pritet të jetë 230 EURO për njësi.

ABC planifikon që cmimi i karrigës të jetë 50% mbi koston totale variabile për njësi, me koston e punës të bazuar në kohën shtesë të nevojitur për të prodhuar njësinë e 8-të

*Kërkohe:*

a) Kalkuloni cmimin e shitjes që "ABC" pritet ta aplikoj për produktin e ri. (shënim: indeksi i të mësuarit për 75% të kurbës së të mësuarit është -0.415). (7 pikë)

b) Faza e parë e prodhimit është finalizuar. Njësia e parë aktualisht ka marrë 12.5 orë kohë për tu prodhuar dhe koha totale për 8-të njësitë e prodhuara ishte 34.3 orë, në të cilën kohë, efekti i të mësuarit përfundoi. ABC pritet të korrigjoj cmimin e shitjes për të reflektuar kohën aktuale të përdorur për të kompletuar njësinë e 8-të.

(i) Kalkuloni normën aktuale të të mësuarit dhe tregoni nëse kjo nënkupton që fuqia punëtore ka mësuar më shpejtë apo më ngadale sesa koha e pritur. (7 pikë)

(ii) Shpjegoni nëse cmimi i korrigjuar i shitjes do të jetë më i lartë apo më i ultë sesa cmimi i përlllogaritur në pjesën (a). Nuk kërkohet nga ju të përlllogarisni cmimin e korrigjuar. (6 pikë)

(total = 20 pikë)

## Zgjidhja e problemit 1

(a) Formular e kohës së të mësuarit =  $y = ax^b$

Koha mesatare kumulative per njësi për 8 njësitë:

$$Y = 12 * 8^{-0.415} = 5.0628948 \text{ orë, andaj koha kumulative totale për 8 njësitë} = 40.503158 \text{ orë}$$

Koha mesatare kumulative për njësi për 7 njësitë:

$$Y = 12 * 7^{-0.415} = 5.3513771 \text{ orë, andaj koha kumulative totale për 7 njësitë} = 37.45964 \text{ orë}$$

Prandaj, koha shtesë (inkrement) për njësinë e 8-të është =  $40.503158 - 37.45964 = 3.043518$  orë

Kosto totale e punës për njësinë e 8-të =  $3.043518 * 15€ = €45.65277$

Materialet dhe shpenzimet e tjera për njësi = €230

Andaj, kosto totale për njësi = 275.65277

Andaj, cmimi total për njësi pritët të jetë = €413.47915  
\*(50% mbi koston totale =  $275.65277 * 1.5$ ).

(b)

(i)

Numri kumulativ i njësive të prodhuara	Numri kumulativ i orëve totale	Mesatarja kumulative e orëve për njësi
1	12.5	12.5
2	?	$12.5 * r$
4	?	$12.5 * r^2$
8	34.3	$12.5 * r^3$

Duke shfrytëzuar algjebren:  $34.3 = 8 * (12.5 * r^3)$

$$4.2875 = (12.5 * r^3)$$

$$r = 0.70$$

Efekti i të mësuarit ishte 70% krahasuar me normën e parashikuar prej 75%, që nënkupton se fuqia punëtore ka mësuar (është adaptuar apo ka qenë më efikas) më shpejtë sesa është pritur nga ta.

(ii)

Cmimi i korigjuar i shitjes do të jetë më i ultë sesa cmimi fillestar i përlllogaritur në pjesën (a). Kjo është e vërtetë, pasi që koha shtesë e njësisë së 8-të do të jetë më e ultë, duke u

bazuar edhe në rezultatin prej 70% të normës së të mësuarit, edhe pse njësia e parë mori 12.5 orë kohë. Këtë e dimë, pasi që është thënë që koha kumulative për 8-të njësitë aktualisht ishte 34.3 orë. Kjo është më e ultë sesa koha e përlllogaritur e llogaritur në pjesën (a) për 8-të njësitë që ishte 40.50315 orë, andaj, logjikisht, koha aktuale shtesë për njësinë e 8-të duhet të jetë më e ultë sesa ajo e parashikuar prej 3.043518 (pjesa a). Si rezultat kësaj, kosto totale do të jetë më e ultë dhe cmimi do të jetë më i ultë.

## Problemi 2

Firma "ABC" është duke marrë në konsideratë prodhimtarinë e një produkti të ri. Ajo ka bërë planifikimin për prodhimin e 50,000 njësive në periudhën e ardhshme dhe ka buxhetuar kostot e prodhimtarisë në vlerë prej €750,000, ku 40% janë kosto fikse. Drejtori Menaxhues i kompanisë ABC cakton kontabilistin menaxherial (MA), kontabilistin financiar (FA) dhe menaxherin e shitjeve (SM) të marrin në konsideratë të dhënat e hulumtimit të tregut në vazhdim:

Çmimi i shitjes për njësi (€)	Vëllimi i shitjeve (njësi)
22	50,000
26	45,000
30	34,000

MA rekomandon pranimin e çmimit të shitjes për njësi prej €26, sepse kjo do të mundësojë maksimizimin e kontributit. FA mbështet çmimin e shitjes për njësi prej €30, sepse kjo do të bëjë maksimizimin e fitimit të llogaritur sipas praktikave normale të kontabilitetit. SM përkrah çmimin e shitjes për njësi prej €22 sepse kjo do të rezultojë me shitjen e të gjitha njësive të planifikuara të prodhimit dhe do të mundësojë maksimizimin e pjesës së tregut.

### Kërkohet

- Llogaritni fitimin duke përdorur caktimin e kostos *sipas sistemit përveçësues* dhe *sistemit variabil* dhe shpjegoni secilën nga këto duke i mbështetë me llogaritjet e duhura. **12 pikë**
  - Si ndryshon caktimi i kostos sipas metodës përveçësuese nga caktimi i kostos sipas metodës variabile? Duke pasur parasysh faktet që ju i konsideroni të rëndësishme, përcaktohuni se cilën prej alternativave ju e konsideroni të jetë më e saktë. **4 pikë**
  - Kur fitimet operative sipas metodës së kostos përveçësuese do t'i tejkalojnë fitimet operative sipas metodës së kostos variabile? **2 pikë**
  - Cilat janë disa nga përparësitë dhe të metat e përdorimit të fitimit neto si masë e profitabilitetit? **2 pikë**
- (total = 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

(a)

### Llogaritjet e nevojshme:

Kostot e prodhimitarisë	€750,000
Kostot fikse (€750,000 × 40%)	€300,000
Kostot variabile (€750,000 - €300,000)	€450,000
Njësi të prodhuara	50,000
Kosto fikse për njësi (€300,000 / 50,000 njësi)	€6
Kosto variabile për njësi (€450,000 / 50,000 njësi)	€9

Kontabilisti Menaxherial (MA) rekomandon çmimin e shitjes prej €26 për njësi sepse kjo do të mundësojë maksimizimin e **kontributit**. Kjo nënkupton se mënyra për llogaritjen e fitimit duhet të bëhet sipas metodës së kostos variabile, andaj kemi:

### Fitimi sipas metodës së kostos variabile

	€	€	€
Çmimi i shitjes për njësi	22	26	30
Njësi të shitura	<u>50,000</u>	<u>45,000</u>	<u>34,000</u>
Shitjet	1,100,000	1,170,000	1,020,000
Kostot variabile	450,000	450,000	450,000
Stoqet (Ll 1)	<u>0</u>	<u>45,000</u>	<u>144,000</u>
Kostoja e shitjes	450,000	405,000	306,000
Kontributi	<u>650,000</u>	<b><u>765,000</u></b>	<u>714,000</u>
Kostot fikse	<u>300,000</u>	<u>300,000</u>	<u>300,000</u>
Fitimi	<u>350,000</u>	<b><u>465,000</u></b>	<u>414,000</u>
<i>Ll 1:</i>			
<i>Prodhimtaria</i>	50,000	50,000	50,000

<i>Njësi të shitura</i>	<u>50,000</u>	<u>45,000</u>	<u>34,000</u>
<i>Stoqet (në njësi)</i>	0	5,000	16,000
<i>Kostot variabile për njësi</i>	<u>— ×</u> <u>€9</u>	<u>— × €9</u>	<u>— × €9</u>
<i>Stoqet (në €)</i>	<u>€0</u>	<u>€45,000</u>	<u>€144,000</u>

Kontabilisti financiar (FA) mbështet çmimin e shitjes për njësi prej €30, sepse kjo do të bëjë maksimizimin e fitimit të llogaritur sipas praktikave normale të kontabilitetit. Fitimi i llogaritur sipas praktikave normale të kontabilitetit nënkupton se mënyra për llogaritjen e fitimit duhet të bëhet sipas metodës së kostos përvetësuese, andaj kemi

#### Fitimi sipas metodës së kostos përvetësuese

	€	€	€
Çmimi i shitjes për njësi	22	26	30
Njësi të shitura	<u>50,000</u>	<u>45,000</u>	<u>34,000</u>
Shitjet	1,100,000	1,170,000	1,020,000
Kostot e prodhimitarisë	750,000	750,000	750,000
Stoqet (Ll 2)	<u>0</u>	<u>75,000</u>	<u>240,000</u>
Kostoja e shitjes	<u>750,000</u>	<u>675,000</u>	<u>510,000</u>
Fitimi	<u>350,000</u>	<u>495,000</u>	<u>510,000</u>

Ll 2:

<i>Prodhimtaria</i>	50,000	50,000	50,000
<i>Njësi të shitura</i>	<u>50,000</u>	<u>45,000</u>	<u>34,000</u>
<i>Stoqet (në njësi)</i>	0	5,000	16,000
<i>Kostot e prodhimitarisë për njësi (€9 + €6)</i>	<u>— × €15</u>	<u>— × €15</u>	<u>— × €15</u>
<i>Stoqet (në €)</i>	<u>€0</u>	<u>€75,000</u>	<u>€240,000</u>

- (b) Sistemet e caktimit të kostove sipas metodës variabile dhe metodës përvetësuese dallohen nga trajtimi i tyre të kostove fikse të prodhimitarisë në vlerësimin e stoqeve. Sistemi i caktimit të kostos sipas metodës variabile **nuk i përfshinë** kostot fikse të prodhimitarisë as në koston e njësisive të shitura e as në vlerën e njësisive të mbetura në stoqe (të pa-shitura).

Sipas këtij sistemi kosto fikse të prodhimit trajtohen si kosto periodike dhe e ngarkojnë periudhën raportuese në të cilën ato shkaktohen. Sistemi i caktimit të koston sipas metodës përvetësuese **përfshinë** koston fikse të prodhimit në koston e njësive të prodhuara respektivisht në koston e njësive të shitura si dhe në vlerën e njësive të mbetura në stoqe (të pa-shitura). Andaj metoda përvetësuese e caktimit të koston lejon që në mënyrë efektive një pjesë të koston fikse të prodhimit e shkaktuar në periudhën aktuale të bartet në një periudhë të mëvonshme (kur shitjet ndodhin).

Në rastin e Kompanisë ABC, kostoja e produktit për njësi sipas metodës variabile është €9.00 (vetëm pjesa e koston variabile) ndërsa kostoja e produktit për njësi sipas metodës përvetësuese është €15.00 ( kostoja variabile €9.00 + kostoja fikse €6.00). Metoda përvetësuese e caktimit të koston jep fitimin maksimal kur produktet shiten çmim prej €30 për njësi. Megjithatë, kjo përfshin mbajtjen e një pjesë të koston fikse të prodhimit të periudhës aktuale për një periudhë të mëvonshme, ku këto kosto nuk do të kenë asnjë ndikim në koston që vërtetë do të shkaktohen në periudhën pasuese. Andaj, për këtë arsye këto kosto janë 'kosto përkatëse për vendimmarrje' në periudhën aktuale dhe nuk mundën thjesht të përjashtohen nga vendimmarrjet që janë para nesh.

Metoda variabile e caktimit të koston i ngarkon të gjitha koston fikse kundrejt fitimit në periudhën në të cilën ato ndodhin, ndërsa koston variabile mund të barten në vlerën e stoqeve të pa-shitura. Megjithatë, këto kosto variabile **do të** ndikojnë në koston që do të shkaktohen në periudhën pasuese. Njësitë e prodhuara në periudhën 1 që shiten në periudhën 2 do të mundësojnë që prodhimitaria në periudhën 2 të zvogëlohet dhe koston respektive variabile të shmangen.

Dy grupet e llogaritjeve më sipër supozojnë se stoqet do të shiten në periudhën pasuese. Atëherë, kur nuk kemi një situatë të tillë, stoqet përfundimtare do të kanë vlerën zero dhe do të ishe e përshtatshme të miratohet një strategji e cila bënë maksimizimin e të hyrave. Kjo do të shpjen te sugjerimi për çmimin e shitjes prej €22 për njësi. Por, strategjia e shitjes e cila bënë maksimizimin e njësive të shitura e përkrahur nga menaxheri i shitjeve (SM) vështirë se do të jetë e përshtatshme - përveç nëse dikush dëshiron të bëjë maksimizimin e pjesës të tregut si pjesë e një koncepti afatgjatë të marketingut.

Nga gjithë kjo rrjedh se çmimi i shitjes i cili maksimizon kontributin d.m.th. çmimi prej €26 për njësi dhe 45,000 të shitura i rekomanduar nga kontabilisti menaxherial (MA) është alternativa më e përshtatshme në të gjitha rrethanat.

- (c) Sistemi i caktimit të koston sipas metodës variabile dallohet nga metoda përvetësuese për shkak se metoda përvetësuese përfshinë koston fikse të prodhimit në koston e njësive të prodhuara, respektivisht në koston e njësive të shitura si dhe në vlerën e njësive të mbetura në stoqe (të pa-shitura). Kjo rezulton me atë se fitimi operativ është i ndjeshëm ndaj luhatjeve në nivelin e stoqeve. Rritjet në nivelin e stoqeve gjatë një periudhe do të rritë fitimin sipas koston përvetësuese mbi fitimin sipas koston variabile, dhe e kundërta ndodhë në qoftë se stoqet zvogëlohen gjatë periudhës.

Nga kjo rrjedh se:



Nëse...

...atëherë fitimi sipas...

- |                             |  |
|-----------------------------|--|
| – ... Prodhimi > Shitjet... | ... kostos përvetësuese > kostos variabile |
| – ... Prodhimi < Shitjet... | ... kostos përvetësuese < kostos variabile |
| – ... Prodhimi = Shitjet... | ... kostos përvetësuese = kostos variabile |

- (d) Fitimi neto duhet të llogariten për qëllime të raportimit të jashtëm. Një avantazh është se fitimi neto llogaritet sipas SNRF kështu që palët e jashtme kanë njohuri për mënyrën sipas së cilës fitimi neto është llogaritur. Fitimi neto është mjaft objektiv; Rregullat janë relativisht të qëndrueshme nga viti në vit. Menaxherët, pra, e dinë se si është llogaritur kjo masë e performancës dhe mund të punojnë për të përmirësuar performancën duke rritur të hyrat dhe/ose zvogëluar shpenzimet.

Fitimi neto ka edhe disavantazhe. Fitimi neto nuk përfshin koston e kapitalit të angazhuar për operacionet e biznesit. Si rezultat, fitimi neto mund të jetë pozitiv, ndërsa kompania po shkatërron pasurinë. Fitimi neto mund të manipulohet me luhatjet e niveleve të stokeve të mbajtura. Fitimi neto mund të rritet në afat të shkurtër, duke marrë veprime që janë të dëmshme në mirëqenien e kompanisë në afat të gjatë (p.sh., me mirëmbajtje paraprake dhe trajnimin e punonjësve).

### Problemi 3

“ABC” prodhon dy produkte të ndryshme: (a) një kalkulator programues dhe (b) një regjistruer me shirit.

Një studim i fundit i tregut tregoi se konsumatorët do të reagonin pozitivisht ndaj një radioje të prodhuar nga “ABC”. Pronari ishte i interesuar për mundësinë e ofruar nga ky hulumtim i tregut. Përpara se të merrej ndonjë angazhim, drejtori dëshironte të dinte, se sa do të *rriteshin* *kostot fikse* dhe *sa radio duhet shitur për të mbuluar këto kosto*.

Si përgjigje, menaxherja e marketingut, mblodhi të dhëna për produktet aktuale, për të ndihmuar në parashikimet e kostove indirekte për produktin e ri. Kostot indirekte jepen më poshtë. (*Vëllimi i lartë dhe i ulët i prodhimit, matur nga orët e punës së drejtpërdrejtë, u përdorën për të vlerësuar sjelljen e kostos.*)

	Fikse	Variabile
Zhvendosja e materialeve	-	€18,000
Energjia	-	22,000
Projektimi	100,000	-
Kostot e makinerisë	30,000	80,000
Inspektimi	40,000	-
Organizimi	60,000	-

Gjithashtu, u mblodhën edhe të dhënat e veprimtarisë që vijojnë:

	Kalkulatorët	Regjistruerët
Njësitë e prodhuara	20,000	20,000
Orët e punës së drejtpërdrejtë	10,000	20,000

Orët e makinerisë	10,000	10,000
Lëvizjet e materialit	120	120
Kilovat-orët	1,000	1,000
Orët e projektimit	4,000	1,000
Orët e inspektimit	700	1,400
Numri i organizimeve	20	40

Një normë (koeficient) e përgjithëshme e kostos indirekte është përdorur për t'u caktuar kostot indirekte, *bazuar në orët e punës direkte*. Gjithashtu nga projektimi menaxherja u informua se nëse do të prodhoheshin dhe do të shiteshin 20,000 radio (parashikimi i saj i bazuar në studimin e tregut), ata do të kishin të njëjtat të dhëna të veprimtarisë sikurse regjistruerit (përdorimi i të njëjtave orë të punës së drejtëpërdrejtë, orë të makinerisë, organizimit, e kështu me radhë).

Projektimi gjithashtu dha vlerësimet shtesë që vijojnë për linjë e produktit të propozuar:

Kostot parësore (primare) për njësi € 18

Amortizimi i pajisjes së re € 18,000

Pas marrjes së këtyre vlerësimeve, menaxherja bëri disa llogaritje të shpejta dhe u ndje e kënaqur, me një çmim shitjeje prej 26€ dhe me vetëm 18,000 € kosto fikse shtesë, për të qenë rentabile (pragu i rentabilitetit), duhet shitur vetëm 4,500 njësi. Meqenëse menaxherja besonte se mund të shiteshin 20,000 njësi, ajo ishte e përgatitur të rekomandonte urgjentisht linjën e produktit të ri.

***Kërkohet:***

1. Kryeni llogaritjet (sipas menaxheres) për pikën apo pragu e rentabilitetit duke përdorur caktimet konvencionale të kostos. Sa fitime priten sipas këtij skenari, duke supozuar shitjen e 20,000 radiove? **(8 pikë)**
2. Përdorni metodën e *kostos të bazuar në veprimtari* dhe *llogaritni pikën rentabël* dhe fitimin rritës që do të nxirret me shitjen e mbi 20,000 njësive. **(8 pikë)**

3. Shpegoni përse analiza e KBV (kostos të bazuar në veprimtari) e bërë në kërkesën 2 është më e saktë se analiza e kryer për Kërkesën 1. *Cfarë rekomandimesh do të jepnit?* (4 pikë)

(total = 20 pikë)

### Zgjidhja e problemit 3

1. *Kostot Variabile për njësi* = (MD + PD) + SHPP variabile = €18 + (SHPPvTOTAL/Total ORET E PUNES DIREKTE - OPD) = €18 + (€120,000/30,000) = €22

*Njësit në pikën e rentabilitetit* = €18,000/(€26 - €22) = 4,500 njësi

*Fitimi mbi pikën e rentabilitetit* = €4 × (20,000 nj - 4,500 nj) = €62,000

2. *Kostot variabile - bazuar në njësi:*

Zhvendosja e materialeve.....	€ 18,000
Energjia.....	22,000
Kostot e Makineris.....	80,000
Total.....	€ 120,000
Orët e Makineris*.....	÷ 20,000
Koeficienti.....	€ 6.00/orë m.

\* Që të tre aktivitetet e kanë të njëjtin koeficient konsumi, kilovat-orë, ose lëvizjen e materialit mund të përdoret edhe si koeficient për kosto

Sh.përgjithshme (€6 × 10,000/20,000).....	€ 3
Kostot Direkte.....	18
Kostot totale variabile për njësi.....	€ 21

*Kostot variabile - bazuar jo në njësi (merr përsipër shpenzimet e ndryshojnë në mënyrë rigorozë me çdo koeficient të koston që nuk kanë pjesë të caktuar, në realitet, të komponenteve të caktuar mund të ekzistojnë për secilin aktivitet dhe disa metoda e koston që ndajn koston fikse dhe variabile duhet të përdoren):*

*Niveli - Produktit:* Projektimi (X<sub>2</sub>) = €100,000/5,000 = €20/orë

*Nivel - Grupi:* Inspektimi (X<sub>3</sub>) = €40,000/2,100 = €19/orët për inspektim

Organizimet(X<sub>4</sub>) = €60,000/60 = €1,000/organizim

*Pika e rentabilitetit në njësi ( kur X<sub>1</sub> është i barabart ):*

$$€26X_1 = €18,000 + €21X_1 + €20X_2 + €19X_3 + €1,000X_4$$

$$X_1 = (€18,000 + €20X_2 + €19X_3 + €1,000X_4)/5$$

$$X_1 = 20,920$$

*Analiza e mësipërme supozon se orët inxhinierike, orët e inspektimit, dhe organizimi pritet se janë realizuar. Në qoftë se nivelet e këtyre tre aktiviteteve ndryshojnë, atëherë edhe pika e rentabilitetit do të do të ndryshojnë. Analiza gjithashtu supozon se amortizimit është një kosto fikse. Në një aktivitet bazuar në një sistem kostonsh , kjo kosto mund të konvertohet në një kosto të ndryshueshme duke përdorur metodën e njësisive-të prodhimit. Nëse do të ishte bërë, duke supozuar se € 18.000 përfaqëson një zhvlersim drejtëvizor pa vlerë të mbetur dhe se*

*prodhimi vjetor pritet të arrihet 20.000 njësi , atëherë kosto variabël për njësi do të rritet me 0,90 €*

*(€18,000/20,000). Në analizën e mësipërme, ky ndryshim e ulë numrusin në €18,000 dhe emruesin në €0.90.*

*Atëher,  $X_1 = €86,600/€4.10 = 21,122$  njësi.*

*3. Analiza CVP në Kërkesat 2 është më i saktë, sepse ajo i e njëj se duke shtuar një produkt do të rrisë koston e aktiviteteve ndihmëse si, inxhinieri inspektimit, dhe organizim. Në analizën e konvencionale, këto kosto shpesh janë të injoruar për shkak se ato janë parë si fikse. Kostot e aktivitetit gjithashtu përpiqen për të identifikuar sjelljet kostove me më shumë kujdes se sa kushton konvencionale. Kjo mund të prodhojë më shumë marrëdhëniet e saktë e koston dhe një analizë më të mirë. Për shembull, për Salem Elektronikë, pika e rentabilitetit që duket të jetë shumë më e lartë se sa analiza origjinale treguar. Dallimi është mjaft i rëndësishëm se vendimi është qartë e kundërta e asaj që ishte sinjalizuar nga analiza konvencionale. Si rezultat, përdorimi i analizës më të saktë ABC është i rekomanduar.*

#### Problemi 4

Kompania "ABC" prodhon një linjë për këpucë vrapimi. Në fillim të periudhës 2019 paraqitën planet që vijojnë, për prodhimin dhe kostot e prodhimit:

<i>Njësitë për prodhim dhe shitje</i>	<b>25,000</b>
Kosto standarde për njësi:	
Materialet e drejtëpërdrejta (MD)	€10
Puna e drejtëpërdrejtë (PD)	8
Shpenzimet indirekte variabile (SHPP-v)	4
Shpenzimet indirekte fikse (SHPP-f)	3
<b><i>Kostoja totale e prodhimit për njësi</i></b>	<b>€25</b>

Gjatë vitit 2019 u prodhuan dhe u shitën 30,000 njësi. Kosto aktuale të prodhimit ishin:

Materiale të drejtëpërdrejta (MD)	€320,000
Punë e drejtëpërdrejtë (PD)	220,000
Shpenzime indirekte variabile (SHPP-v)	125,000
Shpenzimet indirekte fikse (SHPP-f)	89,000

Nuk kishte stoqe fillestare dhe përfundimtare për materialet e drejtëpërdrejta (MD). Mospërputhja (varianca) e çmimit të materialeve të drejtëpërdrejta prej 5,000 € ishte e pafavorshme (PF). Në prodhimin e 30,000 njësive, u punua për një total prej 39,000 orësh, 4% më shumë orë se sa standardi i lejuar për prodhimin aktual. Kostot indirekte iu aplikuan prodhimit, duke përdorur *orët e punës së drejtëpërdrejtë*.

#### ***Kërkohet:***

1. Bazuar në të dhënat e kompanisë "ABC", përgatitsni një raport të performancës, duke krahasuar kostot e pritshme (apo standarde) me me kosto aktuale. **(5 pikë)**

2. Përlllogarisni: (10 pikë)

- a. *Mospërputhjen e përdorimit të materialeve të drejtëpërdrejta.*
- b. *Mospërputhjen e normës së punës së drejtëpërdrejtë.*
- c. *Mospërputhjen e përdorimit të punës së drejtëpërdrejtë.*
- d. *Mospërputhjet e vëllimit dhe të shpenzimit të shpenzimeve indirekte fikse.*
- e. *Mospërputhjet e shpenzimit dhe e efikasitetit të shpenzimeve indirekte variable.*

3. Përdorni T-Llogaritë për të treguar rrjedhën e kostos përgjatë sistemit (në paraqitjen e rrjedhjes, nuk keni nevojë të tregoni mospërputhjet e detajuara të kostove indirekte). Tregoni vetëm mospërputhjet e mbi-dhe-nënaplikuara për *shpenzimet indirekte fikse dhe variable*. (5 pikë)

(totali = 20 pikë)



Zgjidhja e problemit 4

1.

"ABC" Co.  
Raporti i Performancës

	<u>Kostot Aktuale</u>	<u>Kostot e Buxhetuara<sup>a</sup></u>	<u>Varianca</u>
Materialet direkte.....	€ 320,000	€ 300,000	€ 20,000 PF
Puna Direkte.....	220,000	240,000	(20,000) F
Sh.P. Variabile.....	125,000	120,000	5,000 PF
Sh.P. Fikse <sup>b</sup> .....	89,000	75,000	14,000 PF
	<u>€ 754,000</u>	<u>€ 735,000</u>	<u>€ 19,000 PF</u>

<sup>a</sup> Duke e përdorur kostot standard variabile për njësi për materialet direkte, punën direkte, dhe sh.p.p. variabile (psh., €10 × 30,000 për materialet direkte; sh.p.p. fikse = €3.00 × 25,000.

<sup>b</sup> Vetëm variancën e shpenzimeve.

2. a.  $Variance\ Totale = V\check{C}M + VPM$   
 $€20,000\ PF = €5,000\ PF + VPM$   
 $VPM = €15,000\ PF$

b.  $VNP = (NA - NS)OA$

$$OS = 39,000/1.04$$

$$= 37,500\ orë$$

$$NS = €240,000/37,500$$

$$= €6.40$$

$$NS \times OA = €220,000$$

$$VEP = €220,000 - (€6.40 \times 39,000)$$

$$= €29,600\ F$$

c.  $VEP = (OA - OS)NS$   
 $= (39,000 - 37,500)€6.40$   
 $= €9,600\ PF$

$$\begin{aligned}
 d. \text{ Varianca e shpenzimeve (Sh.F.)} &= \text{Aktuale F} - \text{Buxhetuara F} \\
 &= €89,000 - €75,000 \\
 &= €14,000 \text{ F}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{Varianca e Vëllimit} &= \text{Buxhetuara F} - \text{Shkalla SO} \times \text{OS} \\
 &= €75,000 - (€2.40^* \times 37,500) \\
 &= €15,000 \text{ F}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 * \text{Orët e lejuara për njësi} &= 37,500/30,000 \\
 &= 1.25 \text{ ora për punën direkte për njësi}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{ÇOS Fikse} &= €3.00 \text{ njësi}/1.25 \text{ ora për punën direkte për njësi} \\
 &= €2.40 \text{ për orë}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{ÇOS Variablie} &= €120,000/37,500 \\
 &= €3.20
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 e. \text{ Varianca e shpenzimeve variabile prodhimit} &= \text{Sh.p.VA} - \text{NVSSh.VSVOR} \times \text{OA} \\
 &= €125,000 - (€3.20 \times 39,000) \\
 &= €200 \text{ PF}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 \text{VESh.V} &= (\text{OA} - \text{OS}) \text{ÇOS Variabil} \\
 &= (39,000 - 37,500) €3.20 \\
 &= €4,800 \text{ PF}
 \end{aligned}$$

3.

<i>Lënda e Parë</i>				<i>Puna në Proces</i>			
(a)	315,000	315,000	(b)	(b)	300,000	750,000	(f)
				(c)	240,000		
				(d)	120,000		
				(e)	90,000		
<i>Mallrat e gatëshme</i>							
(f)	750,000	750,000	(g)				
<i>VNM</i>				<i>VPM</i>			
(a)	5,000	5,000	(h)	(b)	15,000	15,000	(i)

*Llogarit e Pagueshme*

	<b>320,000</b>	<b>(a)</b>
--	----------------	------------

*Rrogat e Pagueshme*

	<b>220,000</b>	<b>(c)</b>
--	----------------	------------

*VNP*

<b>(j)</b>	<b>29,600</b>	<b>29,600</b>	<b>(c)</b>
------------	---------------	---------------	------------

*LEV*

<b>(c)</b>	<b>9,600</b>	<b>9,600</b>	<b>(k)</b>
------------	--------------	--------------	------------

*Ll.Kontrolluse e Sh.p. Variabile*

<b>125,000</b>	<b>120,000(d)</b>		
	<b>5,000</b>	<b>(l)</b>	

*Ll.Kontrolluse e Sh.p. Variabile*

	<b>89,000</b>	<b>90,000</b>	<b>(e)</b>
<b>(m)</b>	<b>1,000</b>		

*KMSH*

<b>(g)</b>	<b>750,000</b>	<b>29,600</b>	<b>(j)</b>
<b>(h)</b>	<b>5,000</b>	<b>1,000</b>	<b>(m)</b>
<b>(i)</b>	<b>15,000</b>		
<b>(k)</b>	<b>9,600</b>		
<b>(l)</b>	<b>5,000</b>		

## Problemi 5

Departamenti i prodhimit A është pjesë e Kompanisë ABC, që prodhon produktin e quajtur PJESA "X", me një kapacitet vjetor prej 150,000 njësive. Vitin e kaluar, Departamenti i prodhimit A ka shitur 120,000 njësi të produktit "X" blerësve të jashtëm me çmimi të tregut prej €26.50 për njësi. Kostoja e prodhimit për njësi të pjesës "X" është si vijon:

Materialet direkte	€9.00
Puna direkte	5.50
ShPP variabile	1.75
ShPP fikse	2.00
<b>Totali</b>	<b>€18.25</b>

Departamenti i prodhimit B është gjithashtu pjesë e Kompanisë ABC dhe përdorë Pjesën "X" për prodhimin e produktit final të departamentit. Departamentit të prodhimit B i nevojiten **50,000** njësi të "X" në vit. Deri më tani Departamenti i Prodimit B ka blerë pjesën "X" nga furnitorët e jashtëm sipas çmimit të tregut.

Ju, si kontabilist menaxherial i Kompanisë ABC jeni duke u përpjekur të gjeni se çfarë çmimi të transferit të përdoret për shitjen e pjesës "X" nga Departamenti i Prodimit A tek B, dhe t'i rekomandoni Menaxhmentit me qëllim të maksimizimit të fitimit të përgjithshëm të kompanisë. Drejtuesi i Departamentit të prodhimit A argumenton se çmimi i tregut prej **€26.50**, është i përshtatshëm. Drejtuesi i Departamentit të prodhimit B argumenton se duhet të përdoret kostoja *prej* **€18.25**. Çdo njësi e prodhuar nga Departamenti i prodhimit A që nuk transferohet (shitet) tek Departamenti i prodhimit B mund të shitet tek blerësit e jashtëm *prej* **€26.50 për njësi**.

### **Kërkohet:**

- Bazuar në informatat e listuara më lartë, llogarisni fitimin operativ për *Departamentin e prodhimit A* duke përdorur çmimit e transferit prej **€26.50 për njësi**. **5 pikë**
- Bazuar në informatat e listuara më lartë, llogarisni fitimin operativ për *Departamentin e prodhimit A* duke përdorur çmimit e transferit prej **€18.25 për njësi**. **5 pikë**
- Bazuar në informatat e listuara më, çfarë çmimi të transferit do të rekomandonit ju, si kontabilist menaxherial i Kompanisë ABC, me qëllim të *maksimizimit të profitabilitetit të përgjithshëm të kompanisë?* (aplikoni kalkulimet). **5 pikë**
- Bazuar në informatat e listuara më lartë, të llogaritet fitimi operativ për *Departamentin e prodhimit A* duke përdorur çmimit e transferit të *rekomanduar nga ju*. **5 pikë**  
(totali = 20 pikë)

## Zgjidhja e problemit 5

a.	Shitjet e jashtme (100,000 x €26.50)	€2,650,000	
	Shitjet e brendshme (50,000 x €26.50)	<u>€1,325,000</u>	€3,975,000
	Kostoja e mallrave të shitura:		
	Variabile (150,000 x €16.25)	€2,437,500	
	Fikse (150,000 x €2.00)	<u>€300,000</u>	<u>€2,737,500</u>
	Fitimi (e ardhura) operative		<u>€1,237,500</u>
b.	Shitjet e jashtme (100,000 x €26.50)	€2,650,000	
	Shitjet e brendshme (50,000 x €18.25)	<u>€912,500</u>	€3,562,500
	Kostoja e mallrave të shitura:		
	Variabile (150,000 x €16.25)	€2,437,500	
	Fikse (150,000 x €2.00)	<u>€300,000</u>	<u>€2,737,500</u>
	Fitimi (e ardhura) operative		<u>€825,000</u>
c.		<i>Njësi</i>	
	Kërkesa aktuale e jashtme	120,000	
	Kërkesa aktuale e brendshme	<u>50,000</u>	
	Kërkesa totale	170,000	
	Kapaciteti i Divisionit A	<u>150,000</u>	
	Kërkesa mbi kapacitetin	20,000	
	Kërkesa e brendshme	<u>50,000</u>	
	Kërkesa e brendshme jo-konkurente	<u>30,000</u>	

Për shkak se kërkesa aktuale është më e madhe se kapaciteti prodhues (për 20,000 njësi), me qëllim të maksimizimit të fitimit të përgjithshëm të kompanisë, Departamenti A duhet të shfrytëzoi gjithë kapacitetin e vet prodhues (150,000 njësi) dhe nuk duhet të ndëshkohet duke u detyruar të bëjë shitjen e brendshme me çmim më të ulët të transferit.

Të gjitha shitjet deri në nivelin e kërkesës aktuale të jashtme (120,000 njësi = 100,000 njësi + 20,000 njësi) duhet të bëhen sipas çmimit të tregut (€26.50), ndërsa për transferimin e brendshëm të njërive tjera (30,000 njërive), me qëllim të shfrytëzimit të kapacitetit të plotë

prodhues për maksimizimin e fitimit të përgjithshëm të kompanisë, të bëhen sipas çmimit të transferit që mbulon kostot e prodhimit (€18.25 për njësi) që paraqet kursim për Departamenti B (€26.50 - €18.25) krahasuar me blerjen sipas çmimit të tregut, respektivisht maksimizim e fitimit të përgjithshëm të Kompanisë ABC.

Vlen të cekët se Departamenti A nuk do të mund të përmbushë të gjitha kërkesat e jashtme sikurse vitin paraprak dhe kërkesat e blerësve të jashtëm do mbeten të paplotësuara për 20,000 njësi.

d.	Shitjet e jashtme (100,000 x €26.50)	€2,650,000	
	Shitjet e brendshme (20,000 x €26.50)	€530,000	
	Shitjet e brendshme (30,000 x €18.25)	<u>€547,500</u>	<u>€3,727,500</u>
	Kostoja e mallrave të shitura:		
	Variabile (150,000 x €16.25)	€2,437,500	
	Fikse (150,000 x €2.00)	<u>€300,000</u>	<u>€2,737,500</u>
	Fitimi (e ardhura) operative		<u>€990,000</u>